

Sqarim për media

Tiranë, më 30 Dhjetor 2021: Duke u nisur nga disa artikuj dhe lajme në media duhet të sqarojmë se të dhënat në databazën statistikore mund të shkarkohen në formatet si: Excel, JSON-STAT, CSV etj. Në rastet e tabelave me shumë rreshta/kolona, paraqitja në ekran është e limituar (nuk shfaqen të gjitha qelizat).

Në momentin e gjenerimit të të dhënave të përzgjedhura, për rastet e sipërcituara, përdoruesi paralajmërohet për këtë kufizim: “Paraqitja në ekran është e limituar në 1.000 rreshta dhe 30 kolona”. Për më shumë informacione në lidhje me përdorimin e databazës statistikore, lutemi referojuni “Udhëzime të përgjithshme për përdorimin e Bazës së të dhënave statistikore”^{1*}. Për tabelat dhe grafikët që përmbajnë shumë qeliza, përdoruesi duhet ti shkarkojë të dhënat në kompjuterin personal në një nga formatet e ofruara dhe të ndërtojë grafikun sipas interesave.

Për grafikët që përmbajnë shumë të dhëna, paraqitja në ekran është e limituar, të dhënat apo informacionet në boshtet e x/y, mund të mbivendosen me njëra-tjetrën.

^{1*} <http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/>